



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-087

Prishtinë, më 10 dhjetor 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 10 DHJETOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Myzejene Selmani.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3 dhjetor 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 dhjetor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 dhjetor 2012.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë tri mbledhje plenare.

Mbledhja plenare më 12 dhjetor 2012, në orën 10:00, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Adresimi i presidentes së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mbledhja plenare më 12 dhjetor 2012, në orën 12:00, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tretë të zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë

Mbledhja plenare më 13 dhjetor 2012, në orën 10:00, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave dhe kompensimeve të anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pyjet,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Sharri”,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësi,
17. Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit të procedurës penale,
18. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjarët e tyre

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Projektligjin e cekur më lart, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të japë mendim lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjarët e tyre, të hartuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”.
2. Kërkohej nga Ministria e Financave të bëjë verifikimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji.
3. Qeveria e Kosovës duhet ta paraqesë mendimin e vet me shkrim në afatin prej një muaji, nga dita e pranimit të Projektligjit, së bashku me deklaratën për verifikimin e ndikimit buxhetor.

2. Propozimi i deputetit Ramiz Lladrovci, i mbështetur nga grupi i deputetëve nënshkrues, lidhur me renditjen e pikës së veçantë në mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, propozimin e lartcekur e shtyu për mbledhjen e radhës.

3. Propozim-vendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave dhe kompensimet e anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e cekur më lart, e radhiti atë për mbledhjen plenare më 13 dhjetor 2012.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Itali

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, e mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i z. Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit dhe z. Hydajet Hyseni, zëvendëskryetar i Komisionit për Punë të Jashtme, për të marrë pjesë në takimin e Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, që do të mbahet në Itali, më 13-15 dhjetor 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

Pikat shtesë:

1. Rekomandimi i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për pyjet

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e cekur më lart, e radhiti atë për mbledhjen plenare më 13 dhjetor 2012.

2. Kërkesa e deputetit Danush Ademi për lejimin e udhëtimit në Gjermani dhe Suedi

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Deputetit Danush Ademi i arsyetohet mospjesëmarrja në punët e Kuvendit dhe në komisione parlamentare gjatë kohës sa do të qëndrojë në Gjermani dhe Suedi, por Kuvendi nuk merr asnjë detyrim financiar për këtë udhëtim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale